



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR

**RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR
JANAR-Dhjetor 2023**

A. DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE , UJRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR,

D.B.A.P.U&SHV ka në strukturën e saj tre programe të rëndësishme për efektivitetin e veprimtarive në këto fusha që u vijnë në ndihmë fermerëve për zhvillimin e bujqësisë , blegtorisë në cdo Njësi Administrative dhe në qytetin e Beratit,të cilat financohen nga buxheti i Bashkisë Berat dhe nga grantet të transfertave specifike nga Buxheti i Shtetit si më poshtë :

- Menaxhimi i Infarstrukturës së Ujitje dhe Kullim
- Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave
- Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit:

Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të D.B.A.P.U.SHV 12- mujori i vitit 2023

Të Ardhurat e Veta 2023

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, Fakt 2023 dhe fakt për periudhën 12- mujore të 2023.

Planifikimi i të ardhurave, është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, në ecurinë e realizimit të tyre në vitin e mëparshëm dhe trendin e dy viteve të fundit, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

1. Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2023, me ndryshimet përkatëse.
2. Ruajtjen e qëndrueshmërisë të nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.
3. Thellimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve të paregjistruar në organet tatimore.

	Të ardhurat e veta	Fakt	Fakt	Plan	Plan12- mujor	Realizimi 12- mujori	Perqindja
		2021	2022	2023	2023	2023	
1	Tarifë për ujitje dhe kullim	2311	1758	3150	3150	1469	46
2	Administrimi i pyjeve të ardhura nga shitje druve dhe	2987	1865	2411	2411	3558	147

produkteve bujqësoredhe qera në pyje dhe kullota						
--	--	--	--	--	--	--

Tabela përmbledhëse e D.B.A.P.U&SHV me 3 programet :

Emërtimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2023	Plan Buxhet 12/ i rishikuar 2023	Buxheti 12-mujor	Realizimi 12-mujor Janar – Dhjeor 2023	% e Realizimit
600+601	29333	31038	31040	26053	84
602-609	10411	11507	11537	7204	62
230-231	0	5492	5492	2583	50
Totali	38393	46333	48069	35840	74.5

Artikulli 600+601.Në total shpenzimet e Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore jane realizuar ne masen 83 % . Në arti 600+601 kemi mosrealizim të fondit për arsy se në sektorë të drejtorisë kemi vende vakante .

Artikulli 602 Për vitin 2023 kemi realizim në masën 62% , sipas ndryshimeve të zërave të shpenzimeve operative pas fondeve të trashëguara nga viti 2022 .ë. Kemi mos realizime nga diferenca e kontrates se karburantit qe mbartet per vitin 2024.si dhe diferencat qe kane ngelur gjate prokurimeve..

Artikulli 231 Shpenzime Kapitale për vitin 2023jane realizuar si 12 mujor ne masen 50 perqind Mosrealizimi ka ardhur si rezultat I mos kryerjes se tenderimit per blerje mjete transporti nuk u paraqiten asnje ofertues per arsye te rritjes se cmiveve.

PROGRAMI 4240

- 1. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit***

Politika e Programit,

Konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë Berat, me qëllim që t’iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në cdo parcele toke , krijimin e kushteve infrastrukurore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluse. Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27, Funkcionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Rritja e prodhimeve bujqësore dhe zvogëlimi i rrezikut nga përmbytjet duke marrë masa mbrojtjeje nëpërmjet hartimit të projekteve për rehabilitimin/ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit

Aktivitetet kryesore të projektit

1. Evidentimi në vazhdimësi i problematikave kryesore të sistemit ujitës dhe kullues
2. Hartimi i planeve të ndërhyrjeve për pastrim dhe rehabilitim Kanaleve Ujitëse dhe Kanaleve Kulluese.
3. Përcaktimi i volumeve të punës në objektet ku do të nderhyhet.
4. Kryerje e punimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese ne te gjithe territorin e bashkise Berat dhe njesite Adminiartive.

Përshkrimi Përgjithshëmi Programit

Përmirësimi i politikave për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja në përshtatje me ndryshimet klimaterike, duke koordinuar ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja si dhe reformimin e menaxhimit të këtyre sistemeve,

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
-------------------------	-------------------------	-------------------------------

04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e shërbimit të ujitjes dhe kullimit. • Shpenzime për mallra dhe shërbime për aktivitete të ujitjes dhe kullimit. • Shpenzime për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. • Shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve dhe funksionimin teknologjik të tyre. • Shpenzime për investime për rehabilitimin e digave të rezervuarëve dhe rikonstruksionin e kanaleve ushqyes, vaditës dhe kullues, veprave ujore.
-------	---	--

Analiza Financiare Janar - Dhjetor 2023

Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në Drejtorinë B.A.P.U&SH V financohet nga Buxheti i shtetit me **një Grand Specifik nga Ministria e Bujqësisë në Paga Personeli + Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetsore dhe në Shpenzime Operative.**

- Sipas ndarjes ekonomike paraqet këta tregues të përmbledhur të realizimit të buxhetit:
000/ leke

Emërtimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2023	Plan Buxhet 12/mujor I rishikuar 2023	Realizimi 12 mujor Janar – Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601	7009	7999	7093	88.6
602-609	10192	10192	6532	64
230-231	4907	4907	2583	53
Totali	22108	23098	16208	70

Shpenzimet korente, plani vjetor + rishikuar	2309800 lekë,
Plani 12- mujorit	2309800 lekë
Fakti 12- mujorit	16208000 lekë
Realizimi 12- mujorit 70%.	

Artikulli 600+601, shpenzime personeli janë derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqërore e shëndetsore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore.

Artikulli 602 + 609, shpenzimet operative , është realizuar në masën 64%.

Artikulli 230 + 231, investime kapitale është realizuar në masën 53%.JMosrealizimi erdhi si rezultat I mos realizimit te tenderit te blerjes se mjetit te transportit.

Analiza financiare e shpenzimeve operative Janar – Dhjetor 2023

Art	Llog	Emërtimi	Plan Buxhet 2023	Realizimi 12-mujor 2023
6020		Materiale zyre dhe te pergjithshme	400	338
6020	6020100	Kancelari	120	99.7
6020	6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	120	99.8
6020	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyles.(bojra Printeri)	60	49.9
6020	6020500	Blerje dokumentacioni	50	48
6020	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	50	40.5
6021	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale		
6021	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni		
6022		Sherbime nga te trete	240	142.8
6022	6022001	Elektricitet	70	49
6022	6022002	Uje	40	2.4
6022	6022004	Posta dhe sherbim korrier	30	11.2
6022	6022099	Sherbime Interneti	100	80
6023		Shpenzime transporti	4884	3798.8
6023	6023100	Karburant dhe vaj	4585	2586.8
6023	6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	1311	1062
6023	6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	200	149.8
6024		Shpenzime udhetimi	100	16.3
6024	6024100	Udhetim i brendshem.	156	16.3
6024	6024200	Udhetim jashte shtetit.		
6025		Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	3300	2240
6025	6025200	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike Rezervuar + Saracineska		
6025	6025400	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore ,Kanalet Klluese dhe Ujitese	3000	2240
6025	6025500	Shpenzime qiramarrje mjeti transporti	300	
6025		Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes		
		TOTALI	10883	6533

Shpenzimet në mënyrë analitike

- Drejtoria e Bujqësisë , Administrimit të Pyjeve ,Ujrave dhe Shërbimit Veterinar i ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj kompanive furnizuese si OSSH , Ujësjetës Kanalizime Berat – Kucove , dhe Posta Shqiptare.

Spektori i Ujitjes dhe Kullimit, Drejtoria B.A.P.U & SH V gjatë muajve Janar – Dhjetor 2023 ka vijuar punën sipas planifikimeve të kryera në fillim të vitit duke pastruar Kanalet Ujitëse dhe Kulluese me mjetet e drejtorisë, në Njesitë Administrative Otllak, Velabisht dhe Berat kryesisht në fshatrat Lapardha 1, Lapardha 2, Morave, Otllak, Velabisht, Starovë, Gjeroven dhe në Lumin Osum. Konkretisht kemi kryer punët si më poshtë:

Nr	Emertimi	Gjatësia (ml)
1	KK Veterik Remanicë	2210
2	Lapardha 1 Refat Rrethi	4260
3	Parku I Autobuzave	1240
4	Lapardha 1 Nato	2210
5	Hatillaret Gishtonjte	510
6	Bru 30	6230
7	Ushqimore	1230
8	Morave	
9	Devijimi I lumit	
10	Mbrapa kombinatit	

- **Janë pastruar 6230 meter linear kanale Ujitese me mjetet tona dhe 13753 ml me tender**
- **Janë pastruar 13050 meter linear kanale Kulluese.**

Projektet e Investimeve të Programit

Projektet e Investimeve									
Bashkia					Berat				
Programi		04240	Menaxhimi i Infrastruktures se Ujitjes dhe Kullimit						
Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2021	2022	2023	2023
						Fakt	Fakt	Buxh. I Rishikuar	Fakt
1020179	Blerje mjete Transporti	1200	Transf specif	2022	2022	793	793	2200	0
1020114	Blerje Pajisje Kompj dhe printer	250	Transf. Specif.	2022	2022	274	274	150	117
	Shpenzime për rehabilitim te veprave ujore(veshje me beton)	3750	Transf. Specif	2022	2022			2557	2466

PROGRAMI 4260

2-Programi i Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave në funksion të rritjes ekonomike dhe rritjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullimore

Përshkrimi Përgjithshëm i Programit

Programi i administrimit të pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, të praktikave më të mira në fondin pyjor dhe kullor, eficientë nga pikëpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe të pranueshme nga shoqëria. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e rruajtjen e biodiversitetit.

Kodii Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04260	Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave	<ul style="list-style-type: none"> • Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e shërbimit të pyjeve dhe kullotave. • Shpenzime për mallra dhe shërbime për aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të operacioneve pyjore, si dhe shfrytëzimit të kullotave. • Shpenzime për mirëmbajtjen e pyjeve dhe kullotave. • Shpenzime për prodhimin dhe administrimin e druve tëzjarrit për popullatën. • Shpenzime për investime për sistemime dhe vepra malore përmbrojtjen e pyjeve, si dhe përndërtimin dhe rikonstruksionin e ujëmbledhësve malore.

Sipas ndarjes ekonomike paraqet këta tregues të përmbledhur të realizimit të buxhetit Janar – Dhjetor 2023 :

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2023	Plan Buxhet 12/mujori rishikuar 2023	Realizimi 12-mujor Janar – Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601	4788	5534	4733	85.5
602-609	1315	1315	636	48
230-231	585.5		0	0
Totali	6688.5	6849	5369	78

Artikulli 600 + 601, shpenzime personeli është realizuar në masën 85.5%. Janë derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore.

Artikulli 602 + 609, shpenzimet operative , është realizuar në masën 48%.

Artikulli 230 + 231, investime kapitale është realizuar në masën 0% pasi vlera nuk u prokurua për një arsye objektive

Struktura e Pyjeve në drejtori ka 5 punonjës midis tyre 3 inxhinier pyjesh dhe të cilët mbulojnë të gjithë territorin e bashkisë Berat me një sipërfaqe 15.570 ha pyjesh .Në muajin Prill 2023 për një afat 6-mujor kemi parashikuar punësimin e 6 Rojeve sezonal për parandalimin dhe ruajtjen e zjarre në fondin pyjor dhe kullësor në territorin e Bashkisë Berat.

Me qëllim ndalimin e aktiviteteve të paligjshëm në pyje, sidomos shfrytëzimin dhe tregtimin të paligjshëm të materjalit drusor, kemi kryer kontrole të vazhdueshëm në vënde dhe orare të ndryshme.

Për këtë qëllim kemi bashkëpunuar dhe me institucionet e tjerë si Njësia Administrative, kryetarët e fshatrave, Policia e Rendit dhe atë Bashkiake.

Për vitin 2023 DBAPU&ShV ka furnizuar në 12 mujorin e vitit 2023, Drejtorinë Ekonomike Të Arsimit dhe popullatën e qytetit me dru një sasi prej 1225 mst me vlerë 2174212 lekë .

Shpërndarja analitike e shpenzimeve operative analitike për programin 4260 për periudhën Janar –Dhjetor 2023

Art.	Llogaria ekonomike	Emertimi	Plan Buxhet 2023	Realizimi 12-mujor 2023
6022	6022010	Rregjistrim pronash	250	
602.9		Shpenzimeper mirmbajtje vegla pune motorshara	115	95
6023	6023100	Karburant dhe vaj per motor sharra	330	92.5
6024	6024100	Udhetime e dieta	0	
6021	6021002	Plehra kimi, furnitura veterinare	120	119.5
6026	6026400	Shpenzime per qiramarrje mjetesh transporti për transportin e druve .	500	329
		Totali	1315	636
231	1020114	Mjete dhe pajisje te tjera teknike (pajisje per pyjet)		
231		Blerje fidane pise		
231		Rikonstruksim Lera pyjore	585	
		Totali	585	

- Përsa i përket realizimit të buxhetit të sektorit të pyjeve mund të themi se në zërin e shpenzimeve operative jemi me realizim 48 % , mosrealizim janë zëri regjistrim pronash ne vlere 250 mije leke.per arsye te mos lidhjeve te kontratave.
- Gjithashtu në kuadrin e investimeve në zbatim të buxheti 2023 nga sektori i pyjeve dhe kullotave është parashikuar hartimi dhe realizimi i riparimit të një Lere në ekonominë pyjore, fashin Mjeshove per arsye objektive nuk u realizua.

Tabela e Invenstimeve sipas programit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave 2021 dhe 2022

Projektet e Investimeve									
Bashkia									
Programi	04260	Menaxhimi i Pyjeve dhe kullotave							
Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Total e e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2021	2022	2023	2023
						Fakt	Fakt	Buxh. I Rishikuar.	Fakt12 mujori .
1020114	Blerje Motor sharra	120	Transf specif	2022	2022	120	120		
1020180	Blerje peme fidane pishe	700	Transf specif	2022	2022	418	418		
	Shpenzime per ndertimin e mureve rrethuese Lera	585	Transf specif	2023	2023			585	0

PROGRAMI 4220

3. PROGRAMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Ky sektor eshte i fokusuar ne zbatimin e Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky realizim vjen si rezultat i bashkpunit me ZVRPP dhe prefektura.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Përshkrimi i programit :

Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirqënies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas, zhvillimit të kapaciteteve administrative dhe infrastruktures fizike të nevojshme për zbatimin e këtij kuadri normativ si dhe forcimit të kontrollit zyrtar si elementë të rëndësishëm të sistemit të sigurisë ushqimore, për të garantuar jetën dhe shëndetin e konsumatorit, shëndetin dhe mirqënien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve

Shpenzimet korente, plani vjetor **17 535 000 leke,**
Plani 12- mujori, 17535000 leke
Fakti 12- mujori. 14258910 leke **realizimi 81%.**

Sipas ndarjes ekonomike paraqen këta tregues të përmbledhur të realizimit të buxhetit:
000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2022	Plan Buxhet 12/mujor i rishikuar 2023	Realizimi 12-mujor Janar – Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601	17505	17505	14228	81
602-609		30	30	100
230-231				
Totali	17505	17535	14258	81

Artikulli 600 + 601, shpenzime personeli është realizuar në masën 81%. Janë derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore. Kemi një mos realizim për arsye sepse në sektorin e Bujqësisë kemi 3 pozicione vakante .

Artikulli 602 + 609, shpenzimet operative , nuk kemi buxhet të planifikuar.

602				
		Totali		

Sektori i Bujqësisë

Për perjudhën Janar – Dhjetor 2023 si sektor me anë të sp. kadastrës pranë kësaj drejtorie, kemi punuar maksimalisht për tju dhënë zgjidhje sipas procedurave ligjore, të gjitha problemeve që na janë paraqitur pranë drejtorisë tonë apo në Nj. Administrative, si nga fermerët ashtu dhe nga institucionet e tjera si ZVRPP Berat, Prefektura Berat, Ministria e Bujqësisë, Qarku Berat,

Fondi i tokë bujqësore gjithsej si Bashki = 14764 Ha nga kjo:

Tokë shtetërore = 3324 Ha

Tokë e kultivuar = 11440 Ha (mar me ligjin 7501) nga kjo mbjellë me kulturat si më poshtë:

- Ullishte 3724 ha
- Pemë frutore 1143 ha
- Vresht 653 ha
- Bimë arash 5920 ha (drithra, perime, foragjere etj.)

Nga ana jonë janë trajtuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe sipas rastit kemi dërguar kërkesë për plotësim dokumentacioni ZVRPP Berat, fermerëve apo institucioneve te tjera.